



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:147121

Datë: 30.03.2023

Numri i dokumentit: 04138202

**C.nr.101/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtaren Njomëza Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale K.R. në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.S. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat H.S. nga Prizreni, kundër të paditurve Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë në rrugën “.....”, të cilën e përfaqëson B.M. nga Prishtina dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.M. zyrtare ligjore pranë të njëjtës, me objekt të kontestit të kompensimit të dëmit jo material, me vlerë të kontestit 10.000 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor të datës 28.02.2023, morri këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar** padia dhe kërkesëpadia e paditësit R.S. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të: “ *Detyrohen të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë dhe Këshilli Prokurorial që në mënyrë solidare me të paditurën e parë, paditësit të ia kompensojnë në emër të dëmit jo material për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të cenimit të lirisë së komunikimit, dinjitetit, nderit dhe integritetit personal të shkaktuara me aplikimin pa bazë ligjore të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, përgjimeve telekomunikative në periudhën kohore nga data 20.03.2017 datën e lëshimit të urdhërësës për përgjim të telekomunikimve e deri me datë 31.10.2017 datë e pushimit të hetimeve, shumën prej 10.000 Euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë (25.01.2018), e deri në pagimin definitiv, dhe atë në afatin 15 ditor pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm. “*

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi R.S. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij avokat H.S. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurve Këshilli Gjyqësorë i Kosovës me seli në Prishtinë dhe Këshillit Prokurorial me seli në Prishtinë, për shkak të

kompensimit të dëmit jo material. I njëjti në padi ka theksuar se ndaj paditësit e paditura e dytë Këshilli Prokurorial, përkatësisht Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me Aktvendimin PPS.nr.07/2017 të datës 31.10.2017 në Prishtinë i ka pushuar hetimet për dyshimin për kryerjen e veprave penale vrasje e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës nga neni 126 par.1 lidhur me nenin 34 par.1 të KPRK-së dhe përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.1 dhe 2 të KPRK-së. Sipas padisë, paditësi njëkohësisht është njoftuar nga e paditura e rendit të dytë Këshilli Prokurorial i Kosovës, se gjatë kohës së hetimit ka qenë nën masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, në bazë të kërkesës së lëshuar nga e paditura e rendit të dytë e me urdhrin e lëshuar nga e paditura e rendit të parë, respektivisht me urdhëresën e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.N.K.R.nr.56/17, në bazë të të cilave veprime të të paditurave, përkatësisht nga zbatimi i masës së përgjimeve të telekomunikimeve ka rezultuar se paditësi i dyshuar nuk është i involvuar në kryerjen e veprave penale në dyshim. Ndër tjera, paditësi me padi ka theksuar se të paditurat, respektivisht e paditura e rendit të dytë Këshilli Prokurorial i Kosovës me kërkesën për lëshimin e urdhëresës për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe me lëshimin e urdhëresës nga e paditura e rendit të parë Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe me zbatimin e këtyre masave ndaj paditësit pa bazë ligjore, ku nga këto paditësi ka pësuar dëme jo materiale dhe atë dhimbje shpirtërore, ankth dhe vuajtje shpirtërore, shkurtim i të drejtës së komunikimit intim, cenim të autoritetit dhe të personalitetit të tij, me çka ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e tij. Përmes precizimit të padisë të bërë me parashtrësën e datës 09.02.2023 i autorizuari i paditësit pa precizuar dispozitivin e kërkesëpadiës alternative duke i propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit dhe të detyrohen të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës me Seli në Prishtinë dhe Këshilli Prokurorial me seli në Prishtinë që solidarisht të ia kompensojnë paditësit në emër të dëmit jo material për dhimbjet shpirtërore, për shkak të cenimit të lirisë së komunikimit, dinjitetit, nderit dhe integriteti personal të shkaktuar me aplikimin e masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, përgjimeve të telekomunikimeve në periudhën kohore nga data 20.03.2017 datën e lëshimit të urdhëresës për përgjime të telekomunikimeve e deri më datë 31.10.2017 datë e pushimit të hetimeve, shumë prej 10.000 Euro, duke shtuar se nëse gjykata vlerëson se kjo kërkesëpadi nuk e ka bazën ligjore atëherë propozon kërkesëpadi alternative, që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit, ashtu që të detyrohet e paditura Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë për kompensimin e dëmit jo material si në këtë precizim.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari i paditësit ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe deklarimeve në padi duke shtuar se të paditurit e kanë përgjegjësinë e tyre për dëmin e shkaktuar në mënyrë solidarë dhe atë KPK-ja për zbatimin e masave të fshehta dhe KGJK-ja për lëshimin e urdhëresave për masat e fshehta të aplikuara ndaj paditësit. Sipas të autorizuarit të paditësit padia është e bazuar në nenin 96 par.9 të KPPRK-së me të cilën i garantohet paditësit kompensimi i dëmit jo material në rastin e urdhërimit të masave të fshehta, siç është provuar edhe me administrimin e provave të të dy paditurave dhe atë me kërkesën për lëshimin e urdhëresës për masa të fshehta, me aktvendimin për zbatimin e hetimeve dhe zgjerimin e tyre si dhe me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake për urdhërimit të masave të fshehta në bazë të kërkesës së Prokurorisë Speciale të Kosovës. I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare shtoi se me provat e administruara, e veçanërisht me mendimin e ekspertit të psikiatrisë dr.J.Z. është provuar në tërësi kërkesëpadija e paditësit, gjykatës i ka propozuar që kërkesë padinë e paditësit të aprovoj në tërësi si të bazuar në lartësinë e caktuar me kamatë ligjore. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar, dhe atë në emër të padisë 156 euro, në emër të taksës 41 euro, për përfaqësime në seancat gjyqësore shumë prej 540,06 euro, për ekspertizën mjekoligjore në shumë prej 150,00 euro, gjithsej shpenzime në shumë prej 887,80 euro.

E paditura e parë Këshilli Gjyqësor i Kosovës përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar legjitimitetin real pasiv si palë në procedurë, si dhe e ka kundërshtuar padinë e paditësit si të pabazë për faktin se procedura e kompensimit të dëmit për personat ndaj të cilëve zhvillohet gjykim i paarsyeshëm dhe personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye rregullohet me Kodin e Procedurës Penale, respektivisht me dispozitat e kapitullit XXXVI të këtij kodi. E paditura e parë sipas përgjigjes në padi ka potencuar se paditësi nuk ka ofruar dëshmi se me vendim gjyqësor është shpallur i fajshëm, e më vonë është liruar nga dënimi apo edhe se në çfarëdo forme tjetër është privuar nga liria, nuk ka bashkëngjitur asnjë provë dhe se ndaj paditësit sipas padisë është pushuar hetimi dhe se sipas neneve 525 dhe 529 të KPPRK-së paditësi nuk ka bazë për të kërkuar kompensim dëmi sepse nuk hyn në kategorinë e personave që iu njihet kompensimi. Tutje ka shtuar se as Udhëzimi Administrativ i KGJK-së (04/2015) për zbatimin e procedurës së kompensimit e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye nuk parasheh kompensim dëmi për shkak të zhvillimit të procedurës penale, ku sipas këtij udhëzimi i cili në mënyrë të detajuar parasheh rastet e kompensimit dhe Kodit të Procedurës Penale, lejohet kompensimi vetëm për privim të paarsyeshëm nga liria, e që nga shkresat e lëndës ndaj paditësit nuk është shqiptuar ndonjë sanksion penal i formës së prerë. Sa i përket pretendimeve kallëzimit penal të ushtruar ndaj paditësit dhe Aktvendimit me numër PPS.nr.07/2017 të datës 31.10.2017 të nxjerra nga Prokuroria Speciale e Kosovës dhe veprimeve tjera ku gjykata ka qenë e involvuar KGJK-ja ka kundërshtuar në tërësi legjitimitetin real pasiv të palës në procedurë, duke i propozuar gjykatës që të refuzoj kërkesëpadinë si të pabazuar dhe të refuzoj edhe kërkesën për pagimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari i të paditurës së parë ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve të mëhershme duke theksuar se e kundërshtojnë padinë e paditësit si nga baza ashtu edhe nga lartësia për faktin se në shkresat e lëndës paditësi nuk ka qenë i privuar nga liria, qoftë nën masën e arrestit shtëpiak apo në paraburgim dhe se KGJK-ja ka legjitimitet vetëm për rastet e përmendura. E autorizuar e të paditurës së parë ka theksuar se sipas KPPRK-së dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut neni 5 pika 5 e rregullon qartë se kush ka të drejtë kompensimi. Sa i përket ekspertizës së dr.J.Z. e paditura e parë e ka pranuar me kohë dhe meqenëse e ka kundërshtuar padinë që nga fillimi i procedurës ka konsideruar se është e panevojshme të lëshohet në komentimin e asaj ekspertize, nuk e ka kundërshtuar propozimin për prova të reja dhe i ka propozuar gjykatës që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit.

E paditura e dytë Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes përgjigjes në padi ka kërkuar që të refuzohet në tërësi padia si e pathemeltë, pasi që padia nuk përmban bazën juridike ku paditësi e mbështet padinë e tij. Përmes përgjigjes në padi e paditura e dytë ka vlerësuar se organi i prokurorisë në çdo hap të procedurës ka ushtruar autorizimet e parapara ligjore siç parashihen me nenin 109 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe se organi i akuzës ndërmerr veprime procedurale në çdo rast apo rrethanë kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra penale. Gjithashtu ka shtuar se PSRK në rastin konkret ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që ka qenë e obliguar ti ndërmarrë me qëllim të vërtetimit të kryerjes së veprës penale si dhe kryerësit të kësaj vepre, në bazë të nenit 109 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, nenin 24 të ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, e në çoftë se prokurori i shtetit nuk i ndërmerr veprimet e parapara për hetimin, ndjekjen e kryerësve të veprës penale konsiderohet se i njëjti ka bërë sjellje të pahijshme dhe ko nënkupton bazë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj prokurorit. Përmes përgjigjes në padi e paditura e dytës ka deklaruar se në këtë çështje juridiko – civile i mungon legjitimiteti i plotë real pasiv për të qenë palë në kontestin lëndor, pasi që sipas të paditurës së dytë legjitimiteti real është marrëdhënie e palëve

të sajua në bazë të ndonjë raportit juridiko – civil nga e cila rrjedhin të drejtat subjektive dhe me rastin re cenimit të tyre, titullari i të drejtës subjektive të cenuar ka të drejtë të kërkojë mbrojtje ligjore të të drejtës subjektive të cenuar, e që në rastin konkret PSRK nuk ka qenë në ndonjë raport juridiko – civil me paditësin mirëpo ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke i ka propozuar gjykatës që të refuzojë në tërësi si të pathemeltë kërkesëpadinë dhe nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e autorizuar e të paditurës së dytë ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar në raport me KPK-ne duke shtuar se prokurori i shtetit në do hap të procedurës ka ushtruar autorizime siç parashihen në nenin 109 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e në rastin konkret Prokuroria Speciale i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore që ka qenë i obliguar të marre me qëllim të vërtetimit të kryerjes së veprës penale si dhe kryesit të kësaj veprë penale. Gjithashtu ka shtuar se Këshillit Prokurorial të Kosovës i mungon legjitimiteti i plotë real pasiv për të qenë pale në kontestin lëndor, si në theksimet e cekura në përgjigje në padi. E paditura e dytë në shqyrtim kryesor e ka kundërshtuar ekspertizën psikiatrike dhe nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit në raport me KPK ta refuzojë si të pa bazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Ekspertizën mjekoligjore e psikiatrisë e punuar nga dr. J.Z. të datës 06.09.2022; Aktvendimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës PPS.nr.07/2017 të datës 31.10.2017; Njoftimin e të të paditurës KPK- PS me numër PPS.nr. 07/2017 të datës 31.10.2017; Kërkesën për arritjen e marrëveshjes për kompensimin e dëmit të parashtruar ndaj të paditurës KPK me datë 01.04.2021; Përgjigjen e KPK-së lidhur me kërkesën e parashtruar me datë 12.04.2021 me numër 529/2021; Urdhëresën për masa të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit me numër PPS.nr.07/2017 e datës 17.03.2017; Aktvendimin për zgjerimin e hetimeve me numër PPS.nr.07/2017 të datës 28.03.2017; Urdhëresën për lëshimin e urdhrit për përgjim të telekomunikimeve me numër P.N.K.R.nr.56/17 të datës 20.03.2017 si dhe Udhëzimin P.N.K.R.nr.56/17 të datës 20.03.2017.

Eksperti psikiatër Dr. J.Z. të datës 06.09.2022, në ekspertizën e tij të bërë në këtë çështje kontesuese dhe me dëgjimin e tij në seancën e shqyrtimit gjyqësor, i njejtë ka konstatuar se paditësi nga zbatimi i masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit ndaj tij gjatë kohës së hetimit, kishte përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë për periudhën rreth katër muaj, dhimbje dhe vuajtje shpirtërore të intensitetit të mesëm që kanë zgjatuar për pesë muaj si dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët që kanë vazhduar disa muaj pas rastit, por që janë prezente edhe tani. Sipas ekspertizës psikiatrike, paditësi ka përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë rreth katër muaj që nga momenti kur e ka kuptuar se i njëjtë ka qenë duke u përgjuar, duke përjetuar gjendje të rëndë emocionale që është manifestuar e shoqëruar me probleme me gjumin, ndjenjë të frikës, brengës dhe ankthit për të ardhmen e tij, duke pasur parasysh moshën dhe të kaluarën e tij për çështje kombëtare, po ashtu kjo dhimbje është shoqëruar edhe me rënie të herëpashershme të disponimit, mungesë oreksi, rënie në peshë etj, të gjitha këto për shkak të ngjarjes që ka kaluar paditësi dhe familja e tij. Paditësi ka kaluar dhimbje dhe vuajtje shpirtërore të intensitetit të mesëm për pesë muaj, të shoqëruar me ndjenjën e turpërimit për akuzën që ka qenë i ngarkuar, e që nuk ka pasur asnjë bazë dhe asnjë lidhje me këtë rast, ka qenë shumë i shqetësuar, ku ka kërkuar ndihmë mjekësore për probleme të ndryshme që i kanë rrjedhë si pasojë e ngjarjes, e që kanë ndikuar edhe në prishjen e raporteve shoqërore, në aspektin moral, psikik e emocional. Ndër tjerash eksperti ka konstatuar se sot e asaj dite paditësi përjeton dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët, pasi që ka rënie të disponimit, gjendje të rënduar emocionale, prishje e reputacionit shoqëror, profesional që ka pasur paditësi

në rrethin e tij familjar dhe shoqëror, të njëjtit i është cenuar dinjiteti, për faktin se lidhur me veprat që ka qenë duke u hetuar ( përgjuar) rasti ka qenë shumë mediatik dhe ndikimi i mediave ka qenë i atillë që të njoftojë opinionin që i njëjti është duke u hetuar dhe për kundër faktit se nuk ka pasur prova se i njëjti ka kryer veprat penale për të cilat dyshohet, gjendja e tij emocionale ende vazhdon të jetë e renduar dhe jo stabile.

Nga leximi i Aktvendimit të Prokurorisë Speciale të Kosovës PPS.nr.07/2017 të datës 31.10.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se ndaj paditësit R.S. nga Prizreni kanë pushuar hetimet për veprat penale vrasje e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës nga neni 126 par.1 lidhur me nenin 34 par.1 të KPRK-së dhe përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rëndit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.1 dhe 2 të KPRK-së, pasi që me asnjë provë nuk është provuar se i pandehuri – këtu paditësi ka kryer veprat penale për të cilat dyshohet. Gjykata përmes këtij aktvendimi, ka vërtetuar se hetimet ndaj paditësit R.S. kanë filluar me datë 17.03.2017, me aktvendimin PPS.nr.07/2017 për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale vrasje e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës nga neni 126 par.1 lidhur me nenin 34 par.1 të KPRK-së. Hetimi është zgjeruar me aktvendimi PPS.nr.07/2017 të atës 28.03.2017, kundër të njëjtit për veprën përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Nga leximi i Njoftimit të Prokurorisë Speciale të Kosovës PPS.nr.07/2017 të datës 31.10.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka qenë nën masa të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale vrasje e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës nga neni 126 par.1 lidhur me nenin 34 par.1 të KPRK-së dhe përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rëndit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.1 dhe 2 të KPRK-së .

Nga leximi i Kërkesës për arritjen e marrëveshjes për kompensimin e dëmit të parashtruar ndaj të paditurës KPK me datë 01.04.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi paraprakisht i është drejtuar të paditurës së rendit të dytë KPK-së me kërkesën për arritjen e marrëveshjes për kompensimin e dëmit jo material në kuptim të nenit 96 par.9 i KPPRK-së.

Nga leximi Përgjigjes së KPK-së lidhur me kërkesën e parashtruar me datë 12.04.2021 me numër 529/2021, gjykata konstatoi faktin se e paditura e rendit të dytë KPK e ka njoftuar paditësin se Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk është kompetent për arritjen e marrëveshjes.

Nga leximi i Urdhëresës për masa të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit me numër PPS.nr.07/2017 e datës 17.03.2017 gjykata ka konstatuar faktin se Prokuroria Speciale e Kosovës ka kërkuar lëshimin e urdhëresës për masa të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, respektivisht përgjimin e telekomunikimeve përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet e tjera elektronike nga periudha 16.03.2017 në afat prej 60 ditësh, ndaj të pandehurit – këtu paditësit Ruzhdi Saramati.

Nga leximi i Aktvendimin për zgjerimin e hetimeve me numër PPS.nr.07/2017 të datës 28.03.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se ndaj paditësit janë zgjeruar hetimet si i dyshuar për kryerjen e veprave penale vrasje e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës nga neni 126 par.1 lidhur me nenin 34 par.1 të KPRK-së dhe përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rëndit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Nga leximi i Urdhëresës për lëshimin e urdhërit për përgjim të telekomunikimeve me numër P.N.K.R.nr.56/17 të datës 20.03.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, respektivisht gjyqtari i procedurës paraprake me datë 20.03.2017, ka lëshuar urdhëresën për lëshimin e urdhërit për përgjimin e telekomunikimeve për paditësin R.S. për periudhën 60 ditë.

Nga leximi i Udhëzimit P.N.K.R.nr.56/17 të datës 20.03.2017, gjykata ka konstatuar faktin se Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, respektivisht gjyqtari i procedurës paraprake me datë 20.03.2017 ka urdhëruar drejtorin e IPKO-s që t'ia mundësoj Policisë së Kosovës zbatimin e masave të fshehta ndaj paditësit R.S. në numrat e telefonit si në urdhëresë.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

**Kërkesëpadia e paditësit R.S. nga Prizreni është e pabazuar.**

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi sipas urdhëresës të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda P.N.K.R.nr.56/17 të datës 20.03.2017, ka qenë nën masën e fshehtë të vëzhgimit dhe hetimit, respektivisht i është përgjuar telekomunikimi në periudhën kohore prej 60 ditëve. Kontestuese nuk ishte as fakti se, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve me datë 17.03.2017, e që tutje ka bërë kërkesë për lëshimin e urdhëresës për masa të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit ndaj paditësit, e që më vonë me Aktvendimin PPS.nr.07/17 të datës 28.03.2017 janë zgjeruar hetimet. Po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se ndaj paditësit kishin pushuar hetimet si në Aktvendimin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.07/2017 të datës 31.10.2017.

Kontestuese ishte mes palëve ishte nëse masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit ndaj paditësit janë zbatuar konform dispozitave ligjore dhe nëse me rastin e realizimit të këtyre masave të fshehta (përgjimi i telekomunikimeve) paditësit i janë cënuar liritë dhe të drejtat e personalitetit, dhe nëse ka bazë ligjore për kompensim dëmi, ashtu siç ka kërkuar me këtë padi paditësi.

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës janë të rregulluara të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, respektivisht në nenin 36 të saj, si e drejtë themelore e njeriut përcaktohet drejta e privatësisë, ku në paragrafin 1 të këtij neni është paraparë se: *“Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.”*. Ndërsa në par.3 të po këtij neni është paraparë që: *“Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.”*,

Tutje, neni 8 i Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut parasheh: *“1. Çdo njeri ka të drejtën për respekt për jetën e tij private dhe familjare, vendbanimin e tij dhe korrespondencën e tij . 2. Një autoritet publik nuk ndërhyr ndaj ushtrimit të kësaj të drejte përveçse kur kjo është në përputhje me ligjin dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurimit kombëtar, sigurisë publike ose mirëqënies ekonomike të vendit, për parandalimin e*

*çrregullimeve ose krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”.*

Nisur nga dispozitat e lartëcituara përmes të cilave garantohen të drejtat themelore të njeriut, në rastin konkret e drejta e privatësisë, vijmë në përfundim se e drejta e privatësisë është e drejtë themelore e njeriut, që i garantohet secilit njeri si me kushtetutën e vendit tonë ashtu edhe me instrumentet Ndërkombëtare të zbatuara drejtëpërdrejtë në vendin tonë. Përkundër faktit që kjo e drejtë është e garantuar, ajo mund të ketë edhe kufizimet e saj, mirëpo edhe kufizimet, gjegjësisht kontrolli që mund ti bëhet kësaj të drejteje, poashtu është e rregulluar në mënyrë specifike po nga këto dispozita, se kush mund ta kufizojë këtë të drejtë dhe në çfarë mënyre mund të kufizohet.

Në nenin 96 të Kodin e Procedurës penale janë paraparë të drejtat e personave ndaj të cilëve zbatohet urdhri sipas nenit 88, e që sipas paragrafit 9 të këtij neni parashihet se: *“Prokurori shtetëror duhet ta njoftojë me përpikëri me shkrim me anë të postës me rekomandë çdo person të ndonjë urdhri, në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni se ai ose ajo ka qenë subjekt i atij urdhri dhe se ka të drejtë të parashtrrojë padi në gjykatën kompetente brenda gjashtë (6) muajve nga data e njoftimit.”* Prokurori i Shtetit, pas përfundimit të zbatimit të hetimit ndaj tij, e ka njoftuar këtu paditësin se i njejtë ka qenë subjekt i masave të fshehta. Paditësi, pas pranimit të njoftimit të datës 31.10.2017, nga ana e Prokurorit të Shtetit, brenda afatit të lejuar, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi përmes së cilës pretendon se masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit ndaj tij janë zbatuar pa bazë ligjore dhe me këtë rast të njejtë i është shkaktuar dëm jo material, gjegjësisht dhimbje shpirtërore për shkak të cënimit të lirisë së komunikimit, dinjitetit, nderit dhe integritetit personal.

Neni 4 i Ligjit për përgjimin e komunikimeve elektronike, në paragrafin 1 parasheh: *“Parimet themelore dhe udhëheqëse me rastin e përgjimit në përputhje me këtë ligj janë: 1.1. respekti për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të njohura dhe të garantuara me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, përfshirë dhe ashtu siç janë interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përmes praktikës së saj gjyqësore; 1.2. ndalimi i përgjimit pa një vendim përkatës gjyqësor. Përgjim i ligjshëm konsiderohet vetëm ai për të cilin është lëshuar urdhër i ligjshëm nga gjykata kompetente për të autorizuar përgjimin.”* Ndërsa në par.2 parasheh: *“Me rastin e marrjes së vendimit për përgjim, gjykata kompetente bartë detyrimin për t’u kujdesur për: 2.1. esencën e të drejtave dhe lirive të personave për të cilët është bërë kërkesë përgjimi; 2.2. rëndësinë, nevojën e përgjimit, dhe proporcionalitetin; 2.3. natyrën, mjetet dhe vëllimin e përgjimit; 2.4. raportin në mes të qëllimit që synohet të arrihet dhe mundësisë së realizimit të këtij qëllimi me metoda tjera hetuese; dhe 2.5. sekretin dhe objektivitetin gjatë kryerjes së përgjimit.”*

Gjykata, bazuar në dispozitat ligjore të lartëcituara, erdhi në përfundim se përgjimi i telekomunikimeve konsiderohet *“ndërrhyrje”* në të drejtën për *“jetë private”* dhe *“korrespondencë”*. Megjithatë, një *“ndërrhyrje”* e tillë, përmes masës së fshehtë teknike të hetimit të vëzhgimit – përgjimit të telekomunikimeve arsyetohet nëse e njëjta është: (1) *“e përcaktuar në ligj”*; (2) ndjek një *“qëllim legjitim”*; dhe (3) nëse është *“proporcionale”*. Në këtë drejtim, bazuar në të lartëcekuar, gjykata u orientua në sqarimin e tre elementeve të numëruara si më lartë.

Në kohën e zbatimit të masave të fshehta ndaj këtu paditësit, ka qenë në fuqi Kodi i Procedurës Penale me numër 04-L/123. Ndaj paditësit ishin filluar hetimet me datë 17.03.2017 sipas Aktvendimit PPS.NR.07/2017, për *shkak të dyshimit të bazuar* për veprat penale *“vrasje e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës nga neni 126 par.1 lidhur me nenin 34 par.1 të*

KPRK-së”. Ndaj tij hetimi është zgjeruar sipas Aktvendimit PPS.nr.07/2017 të datës 28.03.2017, për shkak të veprës penale “përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.1 dhe 2 të KPRK-së”.

Në bazë të nenit 88 par. 3 të KPPRK-së parashihet se nën cilat kushte ligjore të përcaktuara në KPPK, mund të zbatohen masat e fshehta: “ *Monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, ndërhyrja e komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerja e simuluar e ndonjë sendi, simulimi i një vepre të korrupsionit apo hetimi i fshehtë mund të urdhërohen kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse: 3.1. ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë vepër penale nga neni 90 i këtij Kodi; 3.2. informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.*”, Që do të thotë se në rastin konkret kushti i parë i kërkuar ligjor nga neni i lartëcekur është plotësuar. Në anën tjetër neni 90 par.1.pika 1.1 e KPPK-së parashihet: “*Urdhri nga neni 88 i këtij Kodi mund të përdoret vetëm për hetimin e së paku një nga këto vepra të dyshuara penale: 1.1. veprat penale të dënueshme me pesë (5) ose më shumë vjet burgim;*”. Së këndejmi, veprat për të cilat është dyshuar këtu paditësi hyjnë në grupin e veprave për të cilat lejohet zbatimi i masave të fshehta. Nga kjo del se paditësi, gjegjësisht masa e aplikuar ndaj paditësit ka qenë në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.

Pasi që Gjykata vërtetoi se masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, janë zbatuar konform rregullativës ligjore në fuqi, u orientua në ligjshmërinë e qëllimit, gjegjësisht në drejtim të sqarimit të faktit se cila ka qenë e mira e cënuar, dhe të vlerësohet nëse arsyeja e cënimit të privatësisë, në rastin konkret ndaj paditësit a hynë në grupin e ndërhyrjeve të lejuara të parapara në par.2 të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e që janë si në vijim: 1. Siguria Kombëtare; 2. Siguria Publike. 3 Mirëqenia Ekonomike e Vendit; 4.Parandalimi i trazirave dhe krimit. Në rastin konkret, ndaj paditësit ka ekzistuar dyshimi i bazuar se ka kryer veprat penale “vrasje e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës nga neni 126 par.1 lidhur me nenin 34 par.1 të KPRK-së” dhe “përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.1 dhe 2 të KPRK-së”. Të dy veprat për të cilat është dyshuar hyjnë në grupin e veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, dhe si e tillë e legjitimon qëllimin e ndërhyrjes në jetën private përmes përgjimit.

Gjykata vlerëson se sa i përket elementit të tretë, proporcionalitetit, i njejti duhet vlerësuar gjithmonë për kohën sa është bërë ndërhyrja (përgjimi) dhe jo për kohën kur vlerësohet ky proporcionalitet (sepse në këtë moment dihet se si ka vazhduar rrjedha e dyshimit), ashtu që marr për bazë natyrën e veprave dhe informacioneve që kanë mund të sigurohen me këtë masë, del që cënimi i privatësisë së individit të ketë qenë proporcionale dhe e arsyeshme në raport me vlerën e shoqërisë së rrezikuar, të mirës së përgjithshme që i është kanosur rreziku.

Mbi bazen e te lartëcekurave gjykata vlerësoi se masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit ndaj paditësit janë zbatuar konform dispozitave ligjore në fuqi dhe në harmoni me instrumentet ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, e qe rrjedhimisht paditësit nuk i janë cënuar të drejtat e garantuara me ligj, gjegjësisht ndërhyrja e realizuar nga institucionet Shtetërore, në këtë rast, ka qenë konform një vendimi gjyqësor dhe e arsyetuar.



Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në vendimin e dhënë në *Rastin Klass kundër Gjermanisë, me numër 5029/71, 6 shtator 1978*, i cili është rasti i parë i kësaj gjykate në lidhje me përgjimin, vuri në dukje se përgjimi i telekomunikimeve përbënte domosdoshmërisht cënim të lirisë së komunikimit, për përdoruesit e shërbimeve postare dhe të telekomunikacioneve. Por Gjykata përkundër se bëri këtë konstatim, theksoi se në rastin konkret nga ana e shtetit gjerman, ishin marrë masat e përshtatshme të sigurisë kundër abuzimeve dhe bënin pjesë në përjashtimin e paraparë në par.2 të nenit 8 të Konventës. Ligjvënësi gjerman kishte pasur të drejtë në vlerësimin e këtyre masave, si të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare dhe për ruajtjen e rendit dhe parandalimin e krimit. Si rrjedhojë e kësaj Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të KEDNj-së.

Meqenëse në rastin konkret, gjykata ka vërtetuar se përmes përgjimit të telekomunikimeve që i janë bërë paditësit përmes zbatimit të masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, nuk kemi cënim të të drejtave dhe lirive të personalitetit të paditësit, gjykata në zbatim të nenit 136 par.1 i LMD i cili parasheh se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”*, dhe nenit 137 i LMD-së, i cili e përkufizon dëmin ku thuhet se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material”*, erdhi në përfundim se të paditurat nuk kanë përgjegjësi për shpërblim të dëmit ndaj paditësit, pasi që të njëjtat veprimet e tyre i kanë ndermarrë në harmoni me të gjitha dispozitat ligjore të lartpërmendura, dhe një zbatim i tillë i masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit e përjashton bazën ligjore që paditësit të i njihet e drejta në shpërblim të dëmit siç parashihet në dispozitat e LMD-së për shpërblim të dëmit, në rastet kur cënohen të drejtat dhe liritë e personalitetit.

Në anën tjetër materiali i marrë përmes masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit është konfidencial dhe ka qenë i disponueshëm vetëm për zyrtarët e autorizuar që kanë vepruar sipas urdhëresës së gjykatës dhe në të nuk kanë pasur qasje persona të tjerë sepse kjo është një procedurë strike të cilët e ndjekin zyrtarët e autorizuar për zbatimin e këtyre masave-gjegjësisht të përgjimit, ashtu që zbatimi, ruajtja dhe shkatërrimi i të dhënave të marra përmes përgjimit, ndjekin procedurë specifike e cila parashihet me dispozita të KPPK-së dhe Ligjit për përgjimin e Komunikimeve Elektronike.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata e morri parasysh parashtrësën e të autorizuarit të paditësit për precizimin e padisë, dhe propozimin për paraqitjen e kërkesëpadisë alternative, por duke ju referuar nenit 255 të LPK-së, dhe pas analizimit të precizimit erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dy kërkesëpadi të ndryshme sepse të njëjtat janë identike në mes vete, ashtu që mbi këtë bazë gjykata, konstatoi se nuk kemi të bëjmë me kërkesëpadi alternative, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e refuzuar kërkesëpadinë ndaj të dy të paditurve Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës si të pabazuar sepse kjo kërkesë përfshinë kërkesëpadinë kundër të dy të paditurve dhe si e tillë e përjashton edhe bashkëndërgjyqësinë me të paditurin e eventuale, e në kuptim të nenit 265 të LPK-së.

Për pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, respektivisht lidhur me shpenzimet e procedruës, gjykata vendosi konform nenit 450 të LPK-së, pasi që paditësi ka humbur kontestin, ndërsa të paditurit nuk i kanë kërkuar.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2019:147121, 28.02.2023**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
**Kadire Rexha**

**Gjyqtare,**  
**Njomëza Berisha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, pas marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.